

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 701

KOMUNIKIMI I ÇËSHTJEVE KRYESORE TË AUDITIMIT NË RAPORTIN E AUDITUESIT TË PAVARUR

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

| | Paragrafi (ët) |
|--------------------------------------------------|----------------|
| Hyrje | |
| Objekti i këtij SNA-je | 1-5 |
| Hyrja në Fuqi | 6 |
| Objektivat | 7 |
| Përkufizime | 8 |
| Kërkesat | |
| Përcaktimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit | 9-10 |
| Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit | 11-16 |
| Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen | 17 |
| Dokumentimi | 18 |
| Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese | |
| Objekti i këtij SNA-je | A1-A8 |
| Përcaktimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit | A9-A30 |
| Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit | A31-A59 |
| Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen | A60-A63 |
| Dokumentimi | A64 |

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*, duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësinë e audituesit për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit. Ai synon të trajtojë si gjykimin e audituesit për atë çfarë duhet të komunikohet në raportin e audituesit ashtu edhe formën dhe përmbajtjen e këtij komunikimi.
3. Qëllimi i komunikimit të çështjeve kryesore të auditimit bëhet për të rritur vlerën komunikuese të raportit të audituesit, duke siguruar transparencë më të madhe në lidhje me auditimin që është kryer. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit ofron informacion shtesë për përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare ("përdoruesit e synuar") për t'i ndihmuar ata të kuptojnë ato çështje që, sipas gjykimit profesional të audituesit, kanë qenë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit gjithashtu, mund të ndihmojë përdoruesit e synuar që të kuptojnë entitetin dhe fushat e gjykimeve të rëndësishme të drejtimit në pasqyrat financiare të audituara. (Ref: Para. A1-A4)
4. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit gjithashtu, mund të sigurojë për përdoruesit e synuar një bazë për përfshirje të mëtejshme me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, për disa çështje që kanë lidhje me entitetin, pasqyrat financiare të audituara, apo auditimin e kryer.
5. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit bëhet në kontekstin e formimit nga audituesi të një opinionit lidhur me pasqyrat financiare në tërësi. Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit nuk:
 - (a) Zëvendëson shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare që sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar kërkohet të përgatiten nga drejtimi, ose që përndryshe janë të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë;
 - (b) Zëvendëson shprehjen nga audituesi të një opinionit të modifikuar, kur kërkohet nga rrethanat e një angazhimi auditimi të veçantë, në përputhje me SNA 705 (irishikuar)¹;
 - (c) Zëvendëson raportimin sipas SNA 705 (irishikuar)² kur ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha mbi aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë; ose
 - (d) Është një opinion i ndarë (i veçantë) mbi çështje individuale. (Ref: Para. A5-A8)

¹SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

²SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*, paragrafët 22 – 23

6. Ky SNA zbatohet për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara dhe në rrethanat kur audituesi përndryshe vendos të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit. Ky SNA zbatohet edhe në rastet kur audituesi është i detyruar nga ligji ose rregullat të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit.³ Megjithatë SNA 705 (i rishikuar) e ndalon audituesin të komunikojë çështjet kryesore të auditimit, në rastet kur audituesi refuzon dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, përveç nëse një raportim i tillë kërkohet nga ligji ose rregullat.⁴

Hyrja në Fuqi

7. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë në datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

Objektivat

8. Objektivat e audituesit janë të përcaktojë çështjet kryesore të auditimit dhe, duke formuar një opinion mbi pasqyrat financiare, të komunikojë këto çështje duke i përshkruar në raportin e audituesit.

Përkufizime

9. Për qëllime të këtij SNA - je, termi në vijim ka kuptimin e mëposhtëm:

Çështjet kryesore të auditimit - Ato çështje që, në gjykimin profesional të audituesit, kanë qenë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Çështjet kryesore të auditimit përzgjidhen ndërmjet çështjeve të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Kërkesat

Përcaktimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit

10. Audituesi duhet të përcaktojë, ndërmjet çështjeve të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, ato çështje të cilat kërkojnë prej tij vëmendje të konsiderueshme në kryerjen e auditimit. Në marrjen e këtij vendimi, audituesi duhet të ketë parasysh sa më poshtë: (Ref: Para. A9 – A18)

- (a) Fushat e vlerësuara me rrezik të lartë të anomalisë materiale, ose rreziqe të rëndësishme të identifikuar në përputhje me SNA 315 (irishikuar).⁵ (Ref: Para. A19 – A22)

³SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafët 30 - 31

⁴SNA 705 (I rishikuar), paragrafi 29

⁵SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*

- (b) Gjykimet e rëndësishme të audituesit në lidhje me fusha të pasqyrave financiare të cilat përfshijnë gjykime të rëndësishme të drejtimit, përfshirë çmuarje kontabël që janë identifikuar me pasiguri të lartë të çmuarjes. (Ref: Para. A23 – A24)
 - (c) Efektin mbi auditimin, të ngjarjeve apo transaksioneve të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës. (Ref: Para. A25 – A26)
11. Audituesi do të përcaktojë se cilat prej çështjeve të përcaktuara në përputhje me paragrafin 9, kanë qenë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për këtë arsye, janë çështje kryesore të auditimit. (Ref: Para. A9 – A11, A27 – A30)

Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit

12. Audituesi do të përshkruajë secilën çështje kryesore të auditimit, duke përdorur një nëntitull të përshtatshëm, në një seksion të veçantë të raportit të audituesit nën titullin "Çështjet Kryesore të Auditimit", përveç nëse ekzistojnë rrethanat që jepen në paragrafët 14 ose 15. Paragrafi hyrës në këtë seksion të raportit të audituesit do të deklarojë se:
- (a) Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, në gjykimin profesional të audituesit, kanë qenë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare [të periudhës aktuale]; dhe
 - (b) Këto çështje kanë qenë trajtuar në kuadër të auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit të audituesit mbi to, dhe audituesi nuk jep një opinion të veçantë për këto çështje. (Ref: Para. A31 – A33)

Çështjet Kryesore të Auditimit Nuk Zëvendësojnë Dhënien e një Opinioni të Modifikuar

13. Audituesi nuk do të komunikojë një çështje në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit të raportit të audituesit, kur si rezultat i çështjes, audituesi do të kërkohej të jepte një opinion të modifikuar në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).

Përshkrimi i Çështjeve Individuale Kryesore të Auditimit

14. Përshkrimi i çdo çështje kryesore të auditimit në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit në raportin e audituesit do të përfshijë një referencë tek shënimet shpjeguese përkatëse, nëse ka, në pasqyrat financiare, dhe do të trajtojë:
- (a) Pse çështja ka qenë konsideruar të jetë e një rëndësie të madhe në auditim dhe për këtë arsye është përcaktuar të jetë një çështje kryesore e auditimit; dhe (Ref: Para. A42 – A45)
 - (b) Si është trajtuar çështja në auditim. (Ref: Para. A46 – A51)

Rrethanat në të Cilat një Çështje e Përcaktuar si një Çështje Kryesore e Auditimit Nuk Është Komunikuar në Raportin e Audituesit

15. Audituesi do të përshkruajë çdo çështje kryesore të auditimit në raportin e audituesit, përveç nese: (Ref: Para.A53 – A56)

- (a) Ligj ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të kësaj çështje; ose
- (b) Në rrethana jashtëzakonisht të rralla, audituesi konstaton se çështja nuk duhet të komunikohet në raportin e audituesit pasi pasojat negative të këtij veprimi pritet t'i tejkalojnë në mënyrë të arsyeshme përfitimet në interes të publikut nganjë komunikim i tillë. Kjo nuk do të zbatohet në rastet kur entiteti e ka bërë publik informacionin për këtë çështje.

Ndërveprimi ndërmjet Përshkrimit të Çështjeve Kryesore të Auditimit dhe Elementeve të Tjerë që kërkohet të Përfshihen në Raportin e Audituesit

16. Një çështje që çon në një opinion të modifikuar në përputhje me SNA 705 (i rishikuar), ose një pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë në përputhje me SNA 570 (i rishikuar), janë për nga natyra e tyre çështje kryesore të auditimit. Megjithatë, në rrethana të tilla, këto çështje nuk do të përshkruhen në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit të raportit të audituesit dhe nuk do të zbatohen kërkesat në paragrafët 13-14. Për më tepër, audituesi do të:

- (a) Raportoje mbi këtë / këto çështje në përputhje me SNA (të) e zbatueshme; dhe
- (b) Përfshijë një referencë tek Baza për Opinionin me Rezervë (kundër) ose Pasigurinë Materiale në Lidhje me Vijimësinë, në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit. (Ref: Para. A6 – A7)

Forma dhe Përmbajtja e Seksionit të Çështjeve Kryesore të Auditimit në Rrethana të Tjera

17. Nëse audituesi përcakton, në varësi të fakteve dhe rrethanave të entitetit dhe auditimit, që nuk ka çështje kryesore të auditimit për t'u komunikuar ose që të vetmet çështje kryesore të auditimit që komunikohen janë ato të trajtuara në paragrafin 15, audituesi do të përfshijë një deklaratë për këtë qëllim në një seksion të veçantë të raportit të audituesit nën titullin "Çështjet Kryesore të Auditimit".(Ref: Para.A57-A59)

Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen

18. Audituesi do të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen:

- (a) Ato çështje që ai i ka përcaktuar si çështje kryesore të auditimit; ose

- (b) Nëse është e zbatueshme, në varësi të fakteve dhe rrethanave të entitetit dhe auditimit, vendimin e audituesit që nuk ka çështje kryesore të auditimit për t'u komunikuar në raportin e audituesit. (Ref: Para. A60 – A63)

Dokumentimi

19. Audituesi do të përfshijë në dokumentacionin e auditimit:⁶ (Ref: Para.A64)

- (a) Çështjet që kanë kërkuar vëmendje të konsiderueshme nga audituesi, siç është përcaktuar në përputhje me paragrafin 9, dhe arsyetimin për vendimin e tij, nëse secila nga këto çështje është apo jo një çështje kryesore e auditimit në përputhje me paragrafin 10;
- (b) Ku është e zbatueshme, arsyetimin për vendimin e audituesit që nuk ka çështje kryesore të auditimit për t'u komunikuar në raportin e audituesit ose që të vetmet çështje kryesore të auditimit për të komunikuar janë ato çështje të trajtuara në paragrafin 15; dhe
- (c) Ku është e zbatueshme, arsyetimin për vendimin e audituesit për të mos komunikuar në raportin e audituesit një çështje të përcaktuar si çështje kryesore e auditimit.

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Objekti i këtij SNA-je (Ref: Para. 2)

A1. Rëndësia mund të përshkruhet si rëndësia relative e një çështjeje, të marrë në këtë kontekst. Rëndësia e një çështje është gjykuar nga audituesi në kontekstin në të cilin ajo ka qenë konsideruar. Rëndësia mund të konsiderohet në kontekstin e faktorëve sasiorë dhe cilësorë, të tillë si madhësia përkatëse, natyra, efekti mbi çështjen në fjalë dhe interesat e shprehura të përdoruesve të synuar ose përfituesve. Kjo përfshin një analizë objektive të fakteve dhe rrethanave, përfshirë natyrën dhe shtrirjen e komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen.

A2.Përdoruesit e pasqyrave financiare kanë shprehur një interes në ato çështje për të cilat audituesi ka patur dialogun më të fortë me personat e ngarkuar me qeverisjen, si pjesë e komunikimit të dyanshëm të kërkuar nga SNA 260 (irishikuar)⁷ dhe që kërkojnë për transparencë informacion shtesë në lidhje me këto komunikime. Për shembull, përdoruesit kanë interes të veçantë të kuptojnë gjykimet e rëndësishme të bëra nga audituesi në formimin e opinionit mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak

⁶SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafët 8 – 11 dhe A6

⁷SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*

se shpesh ato janë të lidhura me fusha të rëndësishme të gjykimit të drejtimit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

A3. Kërkesa ndaj audituesve për të komunikuar çështjet kryesore të auditimit në raportin e audituesit gjithashtu, mund të përmirësojë komunikimin ndërmjet audituesit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për këto çështje dhe mund të rritë vëmendjen e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese në shënimet në pasqyrat financiare, të cilat referohen në raportin e audituesit.

A4. SNA 320⁸ shpjegon se për audituesin është e arsyeshme të supozojë se përdoruesit e pasqyrave financiare:

- (a) Kanë njohuri të arsyeshme për biznesin dhe veprimtaritë ekonomike dhe kontabilitetin, si dhe vullnetin për të studiuar informacionin në pasqyrat financiare me kujdes të arsyeshëm;
- (b) Kuptojnë që pasqyrat financiare janë përgatitur, paraqitur dhe audituar për nivelet e materialitetit;
- (c) Njohin pasiguritë e natyrshme në matjen e shumave bazuar në përdorimin e çmuarjeve, gjykimit dhe marrjen në konsideratë të ngjarjeve të ardhshme; dhe
- (d) Marrin vendime të arsyeshme ekonomike mbi bazën e informacionit në pasqyrat financiare.

Për arsye se raporti i audituesit shoqëron pasqyrat financiare të audituara, përdoruesit e raportit të audituesit konsiderohen të jenë të njëjtë me përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare.

Marrëdhënia ndërmjet Çështjeve Kryesore të Auditimit, Opinioni të Audituesit dhe Elementëve të Tjerë të Raportit të Audituesit (Ref: Para. 4, 12, 15)

A5. SNA 700 (i rishikuar) përcakton kërkesat dhe jep udhëzime për formimin e një opinioni mbi pasqyrat financiare.⁹ Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit nuk zëvendëson dhënien e informacioneve shpjeguese në shënimet në pasqyrat financiare, të cilat sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, kërkohet të bëhen nga drejtimi, ose që përndryshe janë të nevojshme për të arritur një paraqitje të drejtë. SNA 705 (i rishikuar) trajton rrethanat në të cilat audituesi arrin në përfundimin se ka një anomali materiale në lidhje me përshtatshmërinë ose mjaftueshmërinë e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare¹⁰.

⁸SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e Auditimit*, paragrafi 4

⁹SNA 700 (i rishikuar), paragrafët 10 – 15 dhe A1 – A15

¹⁰Shiko paragrafin A7 të SNA 705 (i rishikuar)

A6. Kur audituesi shpreh një opinion me rezervë ose opinion kundër, në përputhje me SNA 705 (i rishikuar), paraqitja në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë (Kundër), e përshkrimin të një çështje e cila çon në një opinion të modifikuar, ndihmon për të nxitur përdoruesit e synuar që ata të kuptojnë dhe identifikojnë rrethanat kur ato ndodhin. Duke veçuar komunikimin e kësaj çështje nga çështjet e tjera kryesore të auditimit të përshkruara në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit, kësaj çështje i jepet rëndësia e duhur në Raportin e Audituesit, (shiko paragrafin 15). Shtojca e SNA 705 (i rishikuar) përfshin shembuj ilustrues se si ndikohet paragrafi hyrës në Seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit kur audituesi shpreh një opinion me rezervë ose kundër dhe çështje të tjera kryesore të auditimit janë komunikuar në raportin e audituesit. Paragrafi A58 i këtij SNA-je ilustron mënyrën se si paraqitet seksioni i Çështjeve Kryesore të Auditimit kur audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka çështje të tjera kryesore të auditimit për t'u komunikuar në raportin e audituesit, përtej atyre të trajtuara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë (Kundër) apo seksionin e raportit të audituesit që trajton pasigurinëMateriale në lidhje me Vijimësinë.

A7. Kur audituesi shpreh një opinion me rezervë ose kundër, komunikimi i çështjeve të tjera kryesore të auditimit do të ishte përsëri i përshtatshëm për të përmirësuar kuptimin e auditimit nga përdoruesit e synuar, dhe për rrjedhojë zbatohen kërkesat për të përcaktuar çështjet kryesore të auditimit. Megjithatë, kur është shprehur një opinion kundër në rrethanat kur audituesi ka arritur në përfundimin që anomalitë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare.¹¹

a) Në varësi të rëndësisë së çështjes (eve) që çojnë në një opinionin kundër, audituesi mund të përcaktojë që nuk ka çështje të tjera që të jenë çështje kryesore të auditimit. Në këto rrethana zbatohet kërkesa në paragrafin 15 (shiko paragrafin A58).

b) Nëse një ose më shumë çështje, të ndryshme nga ato që çojnë në një opinion kundër, janë përcaktuar si çështje kryesore të auditimit, është veçanërisht e rëndësishme që përshkrimet e këtyre çështjeve të tjera kryesore të auditimit, të mos nënkuptojnë që pasqyrat financiare në tërësi janë më të besueshme në lidhje me këto çështje nga sa do të ishin të përshtatshme për rrethanat, në këndvështrimin e një opinionin kundër (shiko paragrafin A47).

A8. SNA 706 (i rishikuar)¹² vendos mekanizma për audituesit e pasqyrave financiare të të gjithë entiteteve, për të përfshirë komunikim shtesë në raportin e audituesit nëpërmjet përdorimit të Paragrafëve që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafëve për Çështje të Tjera, kur audituesi e konsideron të nevojshme për ta bërë këtë gjë. Në raste të tilla, këta paragrafë paraqitë në raportin e audituesit, veçmas seksionit të Çështjeve Kryesore të Auditimit. Kur një çështje është përcaktuar si çështje kryesore e auditimit, përdorimi i paragrafëve të tillë nuk zëvendëson përshkrimin e çështjeve individuale

¹¹SNA 705 (i rishikuar), paragrafi 8

¹²SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*

kryesore të auditimit, në përputhje me paragrafin 13.¹³ SNA 706 (i rishikuar) jep udhëzime të mëtejshme për marrëdhënien ndërmjet Çështjeve Kryesore të Auditimit dhe Paragrafëve që Theksojnë Çështjen në përputhje me këtë SNA.¹⁴

Përcaktimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit (Ref: Para. 9 – 10)

- A9. Procesi i vendimmarrjes së audituesit për të përcaktuar çështjet kryesore të auditimit ka për qëllim të zgjedhë një numër më të vogël të çështjeve nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, bazuar në gjykimin e audituesit, për vlerësimin e çështjeve që ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale.
- A10. Përcaktimi nga audituesi i çështjeve kryesore të auditimit kufizohet në ato çështje që kanë rëndësi më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale, madje edhe kur janë paraqitur pasqyrat financiare krahasuese (dmth, edhe kur opinionin e audituesit i referohet çdo periudhe për të cilën janë paraqitur pasqyrat financiare).¹⁵
- A11. Pavarësisht se përcaktimi i audituesit për çështjet kryesore të auditimit bëhet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe ky SNA nuk kërkon nga audituesi që të aktualizojë çështjet kryesore të auditimit të përfshira në raportin e audituesit të periudhës së mëparshme, megjithatë mund të jetë e vlefshme që audituesi të marrë në konsideratë nëse një çështje që ishte një çështje kryesore e auditimit në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme, vazhdon të jetë një çështje kryesore e auditimit në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale.

Çështjet që kërkojnë Vëmendje të Konsiderueshme nga Audituesi (Ref: Para. 9)

- A12. Koncepti i vëmendjes së konsiderueshme të audituesit pranon faktin që një auditim është i bazuar në rrezik dhe fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, në hartimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe në marrjen e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të siguruar një bazë për opinionin e audituesit. Për një tepricë llogarie të caktuar, klasë transaksionesh ose shënimesh shpjeguese, sa më i lartë të jetë rreziku i vlerësuar i anomalisë materiale në nivel pohimi, aq më shumë gjykim përfshihet në planifikimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit dhe vlerësimin e rezultateve të tyre. Në hartimin e procedurave të mëtejshme të auditimit, audituesi duhet të marrë evidencë auditimi më bindëse sa më i lartë të jetë vlerësimi i rrezikut nga audituesi.¹⁶ Gjatë marrjes së evidencës më bindëse të auditimit për shkak të një vlerësimi më të lartë të rrezikut, audituesi mund të rrisë sasinë e evidencës, ose të marrë evidencë që është më e përshtatshmeose e

¹³Shiko paragrafët 8(b) dhe 10(b) të SNA 706 (i rishikuar)

¹⁴SNA 706 (i rishikuar), paragrafët A1 – A3

¹⁵Shiko SNA 710, *Informacionet Krahasuese - Shifrat Korresponduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese*

¹⁶SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*, paragrafi 7(b)

besueshme, për shembull, duke e vendosur më shumë theksin në marrjen e evidencave nga palët e treta ose duke marrë evidencë që konfirmohet nga një numër burimesh të pavarura.¹⁷

A13. Për këtë arsye, çështjet që paraqesin sfida për audituesin në marrjen e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme ose që paraqesin sfida për audituesin në formimin e një opinioni mbi pasqyrat financiare, mund të jenë veçanërisht të rëndësishme në përcaktimin prej tij të çështjeve kryesore të auditimit.

A14. Fushat që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme nga audituesi, shpesh kanë të bëjnë me fushat komplekse dhe ato që kërkojnë gjykime të rëndësishme të drejtimit në pasqyrat financiare, dhe për këtë arsye, shpesh përfshijnë gjykime të vështira apo komplekse të audituesit. Nga ana tjetër, kjo shpesh ndikon në strategjinë e përgjithshme të auditimit të përdorur nga audituesi, në shpërndarjen e burimeve dhe shtrirjen e përpjekjeve të auditimit në lidhje me çështje të tilla. Këto efekte mund të përfshijnë, për shembull, shkallën e përfshirjes së personelit të lartë në angazhimin e auditimit apo përfshirjen e një eksperti të audituesit apo individëve me ekspertizë në një sferë të specializuar të kontabilitetit ose auditimit, qoftë të angazhuar ose të punësuar nga firma për të trajtuar këto fusha.

A15. Disa SNA kërkojnë komunikime të veçanta me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe të tjerët, të cilat mund të lidhen me fushat që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme nga audituesi. Për shembull:

- SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen për vështirësitë e mëdha, nëse ai ka hasur të tilla gjatë auditimit.¹⁸ Ky SNA pranon vështirësitë e mundshme në lidhje me, për shembull:
 - o Transaksionet me palët e lidhura,¹⁹ në veçanti kufizimet në aftësinë e audituesit për të siguruar evidencë auditimi për faktin që të gjitha aspektet e tjera të një transaksioni me palët e lidhura (përveç çmimit) janë ekuivalente me ato të një transaksioni të ngjashëm me vlerën e tregut.
 - o Kufizimet në auditimet e grupit, për shembull, kur aksesit i ekipit të angazhimit të grupit në informacione mund të ketë qenë i kufizuar.²⁰
- SNA 220 përcakton kërkesat për ortakun e angazhimit në raport me marrjen e konsultimit të duhur mbi çështje të vështira ose të diskutueshme.²¹ Për shembull, audituesi mund të jetë konsultuar me të tjerët brenda firmës ose jashtë saj, për një çështje të rëndësishme teknike, e cila mund të jetë një tregues që kjo

¹⁷SNA 330, paragrafi A19

¹⁸SNA 260 (i rishikuar), paragrafët 16(b) dhe A21

¹⁹SNA 550, *Palët e Lidhura*, paragrafi A42

²⁰SNA 600, *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Grupit (duke përfshirë punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)*, paragrafi 49(d)

²¹SNA 220, *Kontrolli i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 18

çështje të jetë një çështje kryesore e auditimit. Ortaku i angazhimit duhet gjithashtu të diskutojë, ndër të tjera, çështje të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit të auditimit, me rishikuesin e kontrollit të cilësisë së angazhimit.²²

Konsideratat në Përcaktimin e atyre Çështjeve që kërkojnë Vëmendje të Konsiderueshme të Audituesit (Ref: Para. 9)

- A16. Audituesi mund të kryejë një vështrim paraprak në fazën e planifikimit të çështjeve që ka të ngjarë të jenë fusha që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme nga audituesi gjatë auditimit dhe për këtë arsye, mund të jenë çështje kryesore të auditimit. Audituesi mund t'i komunikojë ato me personat e ngarkuar me qeverisjen, gjatë diskutimit mbi qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit në përputhje me SNA 260 (i rishikuar). Megjithatë, përcaktimi nga audituesi i çështjeve kryesore të auditimit është bazuar në rezultatet e auditimit ose në evidencën e marrë gjatë auditimit.
- A17. Paragrafi 9 përfshin konsiderata specifike që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme prej tij. Këto konsiderata fokusohen në natyrën e çështjeve të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, të cilat shpesh janë të lidhura me çështje për të cilat jepen informacione shpjeguese në pasqyrat financiare, dhe që synojnë të pasqyrojnë fusha të auditimit të pasqyrave financiare, të cilat mund të jenë me interes të veçantë për përdoruesit e synuar. Fakti që këto konsiderata kërkojnë nuk do të thotë se çështjet e lidhura me to janë gjithmonë çështje kryesore të auditimit; më saktë, çështjet që lidhen me konsiderata të tilla të veçanta janë çështje kryesore të auditimit vetëm nëse ato janë përcaktuar si të një rëndësie më të madhe për auditimin, në përputhje me paragrafin 10. Meqenëse konsideratat mund të jenë të ndërlidhura (p.sh., çështjet që lidhen me rrethanat e përshkruara në paragrafët 9 (b) - (c) mund të identifikohen si rreziqe të mëdha), zbatueshmëria e më shumë se një prej këtyre konsideratave për një çështje të veçantë të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, mund të rrisë gjasat që audituesi ta identifikojë këtë çështje si një çështje kryesore të auditimit.
- A18. Përveç çështjeve që lidhen me konsideratat e veçanta që kërkojnë në paragrafin 9, mund të ketë çështje të tjera të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme nga ana e audituesit dhe që për këtë arsye, mund të përcaktohen si çështje kryesore të auditimit në përputhje me paragrafin 10. Çështje të tilla mund të përfshijnë, për shembull, çështjet që lidhen me auditimin e kryer, për të cilat mund të mos kërkojë të jepen informacione shpjeguese në pasqyrat financiare. Për shembull, zbatimi i një sistemi të ri të TI-së (ose ndryshimet e rëndësishme në një sistem ekzistues të TI-së) gjatë periudhës, mund të jenë një fushë që kërkon vëmendje të konsiderueshme nga audituesi, veçanërisht në qoftë se një ndryshim i tillë ka patur një efekt të rëndësishëm në strategjinë e përgjithshme të auditimit të përdorur nga audituesi apo është e lidhur me një rrezik të konsiderueshëm (p.sh., ndryshimet në sistem që ndikojnë në njohjen e të ardhurave).

²²SNA 220, paragrafi 19

Fushat me Rreziktë Vlerësuar shumë të lartë të Anomalisë Materiale, ose Rreziqet e Rëndësishme të Identifikuara në përputhje me SNA 315 (i rishikuar) (Ref: Para. 9(a))

A19. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen rreth rreziqeve të rëndësishme të identifikuara prej tij.²³ Paragrafi A13 i SNA 260 (i rishikuar) shpjegon që audituesi gjithashtu, mund të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen për mënyrën si ai planifikon të trajtojë fushat me rreziqe të anomalisë materiale, të vlerësuara shumë të larta.

A20. SNA 315 (i rishikuar) e përcakton një rrezik të rëndësishëm si një rrezik të anomalisë, të identifikuar dhe të vlerësuar i cili, në gjykimin e audituesit, kërkon vëmendje të konsiderueshme në auditim. Fushat e gjykimeve të rëndësishme të drejtimit dhe transaksionet e rëndësishme të pazakonta, shpesh mund të identifikohen si rreziqe të rëndësishme. Për këtë arsye, rreziqet e rëndësishme, shpesh janë fusha që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit.

A21. Megjithatë, ky mund të mos jetë rasti për të gjitha rreziqet e rëndësishme. Për shembull, SNA 240 supozon se ka rreziqe të mashtrimit në njohjen e të ardhurave dhe kërkon nga audituesi t'i trajtojë këto rreziqe të vlerësuara të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit si rreziqe të rëndësishme.²⁴ Përveç kësaj, SNA 240 tregon se, për shkak të mënyrës së paparashikueshme me të cilën drejtimi anashkalon kryerjen e kontrolleve, ekziston një rrezik i anomalisë materiale për shkak të mashtrimit, dhe në këtë mënyrë, një rrezik i rëndësishëm.²⁵ Në varësi të natyrës së tyre, këto rreziqe mund të mos kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit, dhe për këtë arsye, nuk do të merren parasysh në përcaktimin nga audituesi të Çështjeve Kryesore të Auditimit në përputhje me paragrafin 10.

A22. SNA 315 (i rishikuar) shpjegon se vlerësimi nga audituesi i rreziqeve të anomalisë materiale në nivel pohimi mund të ndryshojë gjatë kryerjes së auditimit, krahas me marrjen e evidencës shtesë të auditimit.²⁶ Rishikimi nga audituesi i vlerësimin të rrezikut dhe rivlerësimi i procedurave të planifikuara të auditimit në lidhje me një fushë të veçantë të pasqyrave financiare (dmth një ndryshim i rëndësishëm në metodën e auditimit, për shembull, nëse vlerësimi i rrezikut nga audituesi është bazuar në pritshmërinë që disa kontrolle kane funksionuar në mënyrë efektive dhe audituesi ka marrë evidencë auditimi e cila tregon se këto kontrolle nuk kane funksionuar në mënyrë efektive gjatë gjithë periudhës së auditimit, veçanërisht në një zonë me rrezik të vlerësuar të lartë të anomalisë materiale) mund të rezultojë në një fushë që kërkon vëmendje të konsiderueshme të audituesit.

²³SNA 260 (i rishikuar), paragrafi 15

²⁴SNA 240, *Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafët 26 - 27

²⁵SNA 240, paragrafi 31

²⁶SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 31

Gjykime të Rëndësishme të Audituesit që Lidhen me Fusha të Pasqyrave Financiare që Përfshijnë Gjykime të Rëndësishme të Drejtimit, Përfshirë Çmuarjet Kontabël të Identifikuara me Pasiguri të Vlerësimit të Lartë (Ref: Para 9. (b))

A23. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen pikëpamjet e tij në lidhje me aspekte të rëndësishme cilësore të praktikave kontabël të entitetit, përfshirë politikat kontabël, çmuarjet kontabël dhe dhënin e informacioneve shpjeguese në shënimet e pasqyrave financiare.²⁷ Në shumë raste, kjo ka të bëjë me çmuarjet kontabël kritike dhe shënimet shpjeguese përkatëse, të cilat ka të ngjarë të jenë fusha që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit, dhe gjithashtu, mund të identifikohej si rreziqe të rëndësishme.

A24. Megjithatë, përdoruesit e pasqyrave financiare e kanë theksuar interesin e tyre në çmuarjet kontabël që janë identifikuar me pasiguri vlerësimi të lartë në përputhje me SNA 540²⁸, të cilat mund të mos kenë qenë përcaktuar si rreziqe të rëndësishme. Ndër të tjera, vlerësime të tilla janë shumë të varura nga gjykimi i drejtimit, dhe shpesh janë fushat më komplekse të pasqyrave financiare, e që mund të kërkojnë përfshirjen e ekspertëve të drejtimit dhe të audituesit. Përdoruesit kanë nënvizuar, gjithashtu se politikat kontabël që kanë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare (dhe ndryshimet e rëndësishme të këtyre politikave) janë të lidhura me kuptimin nga ana e tyre të pasqyrave financiare, sidomos në rastet kur praktika e një entiteti nuk është në përputhje me të tjera në sektorin përkatës të ekonomisë ku operon entiteti.

Efekti mbi Auditimin e Ngjarjeve ose Transaksioneve të Rëndësishme që kanë Ndodhur gjatë Periudhës (Ref:Para. 9 (c))

A25. Ngjarjet apo transaksionet që kanë patur një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare ose në auditim, mund të jenë fusha që kërkojnë vëmendje të rëndësishme nga audituesi dhe mund të identifikohej si rreziqe të rëndësishme. Për shembull, audituesi mund të ketë patur diskutime të zgjeruara me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen në faza të ndryshme gjatë auditimit, në lidhje me efektin në pasqyrat financiare të transaksioneve të rëndësishme me palët e lidhura apo transaksioneve të rëndësishme që janë jashtë rrjedhës normale të biznesit të entitetit ose që duken të pazakonta.²⁹ Drejtimi mund të ketë bërë gjykime të vështira apo komplekse në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen ose dhënie të informacioneve shpjeguese për keto transaksione, të cilat mund të kenë patur një ndikim të rëndësishëm në strategjinë e përgjithshme të audituesit.

A26. Zhvillimet e rëndësishme ekonomike, kontabël, rregullatore, të sektorit të ekonomisë, apo zhvillime të tjera që kanë ndikuar në supozimet apo gjykimet e drejtimit, mund

²⁷SNA 260 (i rishikuar), paragrafi 16(a)

²⁸Shiko paragrafët 10 – 11 të SNA 540, *Auditimi i Çmuarjeve Kontabël, Përfshirë Çmuarjet Kontabël të Vlerës së Drejtë, dhe Shpjegimet Përkatëse*

²⁹Shiko paragrafët 16(a), 16(c) dhe A22, dhe Shtojcën 2, të SNA 260 (i rishikuar)

të ndikojnë edhe në metodën e përgjithshme të auditimit të audituesit dhe të rezultojnë në një çështje që kërkon vëmendje të konsiderueshme të audituesit.

Çështjet Shumë të Rëndësishme (Ref: Para. 10)

A27. Çështjet që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit mund të kenë një ndërveprim të rëndësishëm me personat e ngarkuar me qeverisjen. Natyra dhe shtrirja e komunikimit në lidhje me këto çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen, shpesh ofron një tregues se cilat çështje janë të një rëndësie më të madhe në auditim. Për shembull, audituesi mund të ketë patur ndërveprime më të thella, të shpeshta ose të forta me personat e ngarkuar me qeverisjen për çështje më të vështira dhe komplekse, të tilla si zbatim i politikave të rëndësishme kontabël që kanë qenë objekt i rëndësishëm i gjykimit të drejtimit apo audituesit.

A28. Koncepti i çështjeve me rëndësi më të madhe është i zbatueshëm në kontekstin e entitetit dhe auditimit që është kryer. Si i tillë, përcaktimi dhe komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit nga audituesi ka për qëllim të identifikojë çështjet specifike të auditimit dhe të përfshijë bërjen e një gjykimi në lidhje me rëndësinë e tyre relative kundrejt çështjeve të tjera të auditimit.

A29. Konsiderata të tjera që mund të jenë të përshtatshme për të përcaktuar rëndësinë përkatëse të një çështje të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe nëse kjo çështje është një çështje kryesore e auditimit, përfshijnë:

- Rëndësinë e çështjes për kuptimin nga përdoruesit e synuar të pasqyrave financiare në tërësi, në mënyrë të veçantë, materialitetin e saj për pasqyrat financiare.
- Natyrën e politikës kontabël bazë në lidhje me këtë çështje apo kompleksitetin ose subjektivitetin e përfshirë në përzgjedhjen nga drejtimi të një politike të përshtatshme në krahasim me entitetet e tjera brenda të njëjtit sektor të ekonomisë.
- Natyrën dhe materialitetin, sasior ose cilësor, e gabimeve të korrigjuara dhe atyre të akumuluar të pakorrigjuara, për shkak të mashtrimit apo gabimit që lidhen me këtë çështje, nëse ka.
- Natyrën dhe shtrirjen e përpjekjeve të nevojshme të auditimit, për të trajtuar çështjen, duke përfshirë:
 - Shkallën e aftësive të specializuara ose njohurive që duhen për të zbatuar procedurat e auditimit për trajtimin e çështjes ose për të vlerësuar rezultatet e këtyre procedurave, nëse ka.
 - Natyrën e konsultimeve jashtë grupit të angazhimit në lidhje me këtë çështje.

- Natyrën dhe shkallën e vështirësive në zbatimin e procedurave të auditimit, vlerësimin e rezultateve të këtyre procedurave, dhe marrjen e evidencës përkatëse dhe të besueshme, mbi të cilën të bazohet opinioni i audituesit, në veçanti kur gjykimet e audituesit bëhen më subjektive.
- Seriozitetin e çdo mangësie të identifikuar në kontrollet që lidhet me këtë çështje.
- Faktin nëse kjo çështje përfshin një numër konsideratash auditimi të veçanta por të ndërlidhura. Për shembull, kontratat afatgjata mund të përfshijnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit për sa i përket njohjes së të ardhurave, padive gjyqësore apo kontigjencave të tjera, dhe mund të kenë efekt mbi çmuarjet e tjera kontabël.

A30. Përcaktimi se cila, dhe sa, nga këto çështje që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit kanë qenë të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale, është një çështje e gjykimin profesional. Numri i çështjeve kryesore të auditimit që do të përfshihen në raportin e audituesit mund të ndikohet nga madhësia dhe kompleksiteti i entitetit, natyra e biznesit dhe mjedisit të tij, dhe faktet e rrethanat e angazhimit të auditimit. Në përgjithësi, sa më i madh të jetë numri i çështjeve të përcaktuara fillimisht si çështje kryesore të auditimit, aq më shumë audituesi mund të ketë nevojë të rishikojë nëse secila nga këto çështje plotëson përkufizimin e një çështje kryesore të auditimit. Listat e gjata të çështjeve kryesore të auditimit mund të jenë në kundërshtim me nocionin që këto çështje të jenë të një rëndësie më të madhe në auditim.

Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit

Seksioni i Veçantë për Çështjet Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit (Ref: Para.11)

- A31. Vendosja e një seksioni të veçantë për Çështjet Kryesore të Auditimit pranë seksionit të opinionit të audituesit i jep rëndësi këtij informacioni dhe pranon vlerën e perceptuar të informacionit specifik të angazhimit për përdoruesit e synuar.
- A32. Radha e paraqitjes së çështjeve individuale brenda seksionit të Çështjeve Kryesore të Auditimit është një çështje e gjykimin profesional. Për shembull, një informacion i tillë mund të organizohet sipas rëndësisë përkatëse, bazuar në gjykimin e audituesve ose mund të korrespondojë me mënyrën në të cilën çështjet janë shpjeguar në pasqyrat financiare. Kërkesa në paragrafin 11 për të përfshirë nëntitujt synon të diferencojë më tej çështjet.
- A33. Në rastet kur paraqitet informacion financiar krahasues, paragrafi (teksti) hyrës i seksionit të Çështjeve Kryesore të Auditimit, do të përshtatet për të tërhequr vëmendjen për faktin se çështjet kryesore të auditimit të përshkruara, lidhen vetëm me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe mund të përfshijë një

referencë për periudhën specifike që mbulohet nga këto pasqyra financiare (p.sh., "për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 20X1").

Përshkrimi i Çështjeve Individuale Kryesore të Auditimit (Ref: Para. 13)

- A34. Mjaftueshmëria e përshkrimit të një çështje kryesore të auditimit është çështje e gjykimit profesional. Përshkrimi i një çështje kryesore të auditimit ka për qëllim të japë një shpjegim të përmbledhur dhe të ekuilibruar për të bërë të mundur që përdoruesit e synuar të kuptojnë pse çështja ka qenë e një rëndësie më të madhe në auditim dhe mënyrën se si ajo është trajtuar në auditim. Kufizimi i përdorimit të termave të auditimit shumë teknike, gjithashtu ndihmon për të bërë të mundur që përdoruesit e synuar, të cilët nuk kanë njohuri të arsyeshme mbi auditimin, të kuptojnë bazën për fokusimin e audituesit mbi çështjet e veçanta gjatë auditimit. Natyra dhe shtrirja e informacionit të dhënë nga audituesi ka për qëllim të jetë ekuilibruar në kuadër të përgjegjësive të palëve përkatëse (dmth, dhënia nga audituesi e një informacioni të dobishëm në një formë të përmbledhur dhe të kuptueshme, duke mos qenë dhënësi i informacionit origjinal për entitetin).
- A35. Informacion origjinal është çdo informacion në lidhje me entitetin, që nuk është bërë i disponueshëm për publikun nga entiteti në forma të tjera (p.sh., nuk është përfshirë në pasqyrat financiare ose në informacionet e tjera të disponueshme në datën e raportit të audituesit, ose nuk është trajtuar në komunikimet e tjera me gojë ose me shkrim nga drejtimi ose personat e ngarkuar me qeverisjen, në formën e një njoftimi paraprak të informacionit financiar apo përmbledhjeve informuese nga investitori). Një informacion i tillë është përgjegjësi e drejtimit të entitetit dhe e personave të ngarkuar me qeverisjen.
- A36. Për audituesin është e përshtatshme të kërkojë shmangien e përshkrimit të papërshtatshëm të një çështje kryesore të auditimit, përmes sigurimit të informacionit origjinal në lidhje me entitetin. Zakonisht, përshkrimi i një çështje kryesore të auditimit nuk është në vetvete një informacion origjinal për entitetin, siç përshkruhet në kontekstin e auditimit. Megjithatë, audituesi mund të konsiderojë të nevojshme përfshirjen e informacionit shtesë, për të shpjeguar pse kjo çështje ka qenë konsideruar një nga çështjet me rëndësi më të madhe në auditim dhe për këtë arsye, ka qenë përcaktuar si një çështje kryesore e auditimit, dhe mënyra si ajo është trajtuar në auditim, me kusht që dhënia e informacioneve të tilla të mos ndalohet nga ligji ose rregullat. Kur ky informacion konsiderohet i nevojshëm për audituesin, ky i fundit mund të inkurajojë drejtimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen, të japin informacion shpjegues shtesë, në vend që ta sigurojë vetë informacionin origjinal në raportin e audituesit.
- A37. Drejtimi apo personat e ngarkuar me qeverisjen mund të vendosin përfshirjen e informacioneve shpjeguese të reja ose të zgjeruara në pasqyrat financiare apo diku tjetër në raportin vjetor në lidhje me një çështje kryesore të auditimit, në dritën e faktit se çështja do të komunikohet në raportin e audituesit. Këto informacione shpjeguese të reja ose të zgjeruara, për shembull, mund të përfshihen për të dhënë

informacione më të plota në lidhje me ndjeshmërinë e supozimeve kryesore të përdorura në çmuarjet kontabël apo arsyetimin e entitetit për një praktikë të caktuar apo politikë kontabël, kur ekzistojnë alternativa të pranueshme sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.

- A38. SNA 720 (i rishikuar) përcakton termin raport vjetor dhe shpjegon se dokumente të tilla si raporti i drejtimit, komentari i drejtimit, ose rishikimet financiare dhe operacionale apo raporte të ngjashme të përgatitura nga personat e ngarkuar me qeverisjen (p.sh., raportii drejtorëve) deklarata e Kryetarit, deklarata e qeverisjes të korporatës; ose raportet e kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të rrezikut, mund të jenë pjesë e raportit vjetor.³⁰ SNA 720 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionin tjetër të përfshirë në raportin vjetor. Edhe pse opinioni i audituesit mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionin tjetër, audituesi mund ta marrë në konsideratë këtë informacion, sikurse edhe komunikimet e tjera të entitetit, të vëna në dispozicion të publikut ose burime të tjera të besueshme, kur ai formulon përshkrimin e një çështjeje kryesore të auditimit.
- A39. Dokumentacioni i auditimit i përgatitur gjatë auditimit mund të jetë gjithashtu, i dobishëm për audituesin në formulimin e përshkrimit të një çështjeje kryesore të auditimit. Për shembull, komunikimet me shkrim, ose dokumentimi nga audituesi i komunikimeve me gojë me personat e ngarkuar me qeverisjen, si dhe dokumentacionet e tjera të auditimit japin një bazë të dobishme për komunikimin e audituesit në raportin e audituesit. Kjo për faktin se dokumentacioni i auditimit i përgatitur në përputhje me SNA 230 synon të trajtojë çështjet e rëndësishme që dalin gjatë auditimit, konkluzionet e arritura në lidhje me to dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra për të arritur në këto konkluzione, si dhe shërben si një regjistrim për natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera, të rezultateve të këtyre procedurave, dhe të evidencës së auditimit të siguruar. Një dokumentacion i tillë mund të ndihmojë audituesin në zhvillimin e përshkrimit të çështjeve kryesore të auditimit që shpjegon rëndësinë e çështjes dhe gjithashtu, në zbatimin e kërkesave të dhëna në paragrafin 18.

Referenca se Ku është Shpjeguar Çështja në Pasqyrat Financiare (Ref: Para.13)

- A40. Paragrafët 13(a)-(b) kërkojnë përshkrimin e çdo çështjeje kryesore të auditimit për të trajtuar pse audituesi e ka konsideruar çështjen si një nga çështjet me rëndësi më të madhe për auditimin dhe mënyrën si është trajtuar kjo çështje gjatë auditimit. Për këtë arsye, përshkrimi i çështjeve kryesore të auditimit nuk është thjesht një përsëritje e asaj që është shpjeguar në pasqyrat financiare. Megjithatë, një referencë për çdo dhënie informacioni shpjegues përkatës, ju jep mundësi përdoruesve të synuar, të kuptojnë më tepër se si drejtimi e ka trajtuar çështjen në përgatitjen e pasqyrave financiare.

³⁰SNA 720 (I rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera*, paragrafët 12(a) dhe A1 – A3

A41. Për më tepër, duke iu referuar informacioneve shpjeguese përkatëse, audituesi mund të tërheqë vëmendjen për aspektet kryesore të tyre. Shkalla e dhënies së informacioneve shpjeguese nga drejtimi mbi aspektet e veçanta apo faktorët që tregojnë se si një çështje e veçantë ndikon në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, mund të ndihmojë audituesin në përzgjedhjen e aspekteve të veçanta të mënyrës se si çështja u trajtua në auditim, në mënyrë që përdoruesit e synuar të mund të kuptojnë pse ajo është një çështje kryesore e auditimit. Për shembull:

- Kur një entitet përfshin informacione shpjeguese të forta në lidhje me çmuarjet kontabël, audituesi mund të tërheqë vëmendjen mbi informacionet që shpjegojnë supozimet kryesore, informacionet që shpjegojnë intervalin e rezultateve të mundshme, dhe informacionet e tjera shpjeguese cilësore dhe sasiore në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së çmuarjes apo të çmuarjeve kontabël kritike, si pjesë e trajtimit pse çështja ka qenë e një rëndësie më të madhe për auditimin dhe e mënyrës se si çështja ka qenë trajtuar në auditim.
- Kur audituesi në përputhje me SNA 570 (i rishikuar) arrin në përfundimin se nuk ekziston asnjë pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, ai megjithatë mund të përcaktojë se një ose më shumë çështje që lidhen me këtë përfundim, që rrjedhin nga përpjekjet e punës së audituesit sipas SNA 570 (i rishikuar) janë çështje kryesore të auditimit. Në rrethana të tilla, përshkrimi i audituesit për këto çështje kryesore të auditimit në raportin e audituesit, mund të përfshijë aspekte të ngjarjeve të identifikuar apo kushteve të shpjeguara në pasqyrat financiare, siç janë humbjet e konsiderueshme të veprimtarive të shfrytëzimit, mundësitë disponibël të huamarrjes dhe rifinancimi i mundshëm i borxhit, apo papajtueshmëria me marrëveshjet e huasë, dhe faktorët përkatës lehtësues.³¹

Pse Audituesi e ka Konsideruar Çështjen si Një nga Çështjet më të rëndësishme në Auditim (Ref: Para. 13 (a))

A42. Përshkrimi i një çështjeje kryesore të auditimit në raportin e audituesit synon të sigurojë informacion se pse çështja është përcaktuar si një çështje kryesore e auditimit. Për këtë arsye, kërkesat në paragrafët 9-10 dhe materiali zbatueshëm në paragrafët A12-A29 që lidhen me përcaktimin e çështjeve kryesore të auditimit, mund të jenë gjithashtu, të dobishëm për audituesin për të vlerësuar se si këto çështje duhet të komunikohen në raportin e audituesit. Për shembull, shpjegimi i faktorëve që çuan audituesin në përfundimin se një çështje e veçantë kërkonte vëmendje të konsiderueshme nga audituesi dhe ishte e një rëndësie më të madhe në auditim, ka të ngjarë të jetë me interes për përdoruesit e synuar.

A43. Përshtatshmëria e informacionit për përdoruesit e synuar është një aspekt për t'u marrë në konsideratë nga audituesi në përcaktimin se çfarë duhet të përfshijë në

³¹Shiko paragrafin A3 të SNA 570 (i rishikuar)

përshkrimin e një çështjeje kryesore të auditimit. Kjo mund të përfshijë faktin nëse përshkrimi do të mundësonte një kuptim më të mirë të auditimit dhe të gjykimeve të audituesit.

A44. Lidhja e një çështjeje direkt me rrethanat specifike të entitetit mund të ndihmojë për të minimizuar potencialin që përshkrime të tilla të bëhen tepër të standardizuara dhe më pak të dobishme me kalimin e kohës. Për shembull, disa çështje mund të përcaktohen si çështje kryesore të auditimit në një sektor ekonomik të veçantë në një mori entitetesh për shkak të rrethanave të sektorit apo kompleksitetit të nënkuptuar në raportimin financiar. Kur përshkruan pse e ka konsideruar çështjen si të një rëndësie më të madhe, për audituesin mund të jetë e dobishme të nxjerrë në pah aspekte të veçanta të entitetit (p.sh., rrethanat që kanë ndikuar gjykimet e nënkuptuara të bëra në pasqyrat financiare të periudhës që auditohet) në mënyrë që ta bëjë përshkrimin më të përshtatshëm për përdoruesit e synuar. Kjo gjithashtu, mund të jetë e rëndësishme në përshkrimin e një çështjeje kryesore të auditimit, që përsëritet gjatë periudhave.

A45. Përshkrimi mund t'i referohet faktorëve kryesorë që, në kushtet e auditimit, kanë bërë të mundur përcaktimin nga audituesi të çështjes si të një rëndësie më të madhe, për shembull:

- Kushtet ekonomike që ndikuan në aftësinë e audituesit për të marrë evidencë auditimi, për shembull tregjet jolikuide për disa instrumente financiare.
- Politika kontabël të reja apo në zhvillim, për shembull çështje specifike të entitetit ose të sektorit të ekonomisë, për të cilat grupi i angazhimit konsultohet brenda firmës.
- Ndryshimet në strategjinë ose modelin e biznesit të entitetit, të cilat kanë patur një efekt material në pasqyrat financiare.

Si Është Trajtuar Çështja në Auditim (Ref: Para. 13 (b))

A46. Sasia e detajeve që duhet të jepen në raportin e audituesit për të përshkruar mënyrën se si një çështje kryesore auditimi ka qenë trajtuar në auditim, është çështje e gjykitimit profesional. Në përputhje me paragrafin 13(b), audituesi mund të përshkruajë:

- Aspekte të përgjigjes apo metodës së audituesit që kanë qenë më të përshtatshme për çështjen ose specifike për rrezikun e vlerësuar të anomalisë materiale;
- Një përmbledhje të shkurtër të procedurave të kryera;
- Një tregues të rezultateve të procedurave të audituesit; ose
- Vëzhgimet kryesore në lidhje me çështjen,

ose një kombinim të këtyre elementeve.

Ligji, rregullat apo standardet kombëtare të auditimit, mund të përcaktojnë një formë apo përmbajtje specifike për përshkrimin e një çështjeje kryesore të auditimit, ose mund të specifikojnë përfshirjen e një ose më shumë prej këtyre elementëve.

A47. Në mënyrë që përdoruesit e synuar të kuptojnë rëndësinë e një çështjeje kryesore të auditimit në kuadër të auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, si dhe marrëdhëniet midis çështjeve kryesore të auditimit dhe elementeve të tjera të raportit të audituesit, përfshirë opinionin e audituesit, duhet bërë kujdes që gjuha e përdorur në përshkrimin e një çështjeje kryesore të auditimit:

- Të mos lërë të kuptohet se çështja nuk është zgjidhur në mënyrën e duhur nga ana e audituesit kur ai ka formuar opinionin mbi pasqyrat financiare.
- Të lidhë çështjen drejtpërdrejt me rrethanat specifike të entitetit, duke shmangur gjuhën e përgjithshme ose të standardizuar.
- Të marrë parasysh se si çështja është trajtuar në informacionin/et shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare, nëse ka.
- Të mos përmbajë ose përfshijë opinione mbi elemente të veçanta të pasqyrave financiare.

A48. Përshkrimi i aspekteve të përgjigjes apo metodës së audituesit ndaj një çështjeje, në veçanti kur metoda e auditimit kërkon një përshtatje të rëndësishme me faktet dhe rrethanat e entitetit, mund të ndihmojë përdoruesit e synuar të kuptojnë rrethanat e pazakonta dhe gjykimin e rëndësishëm të audituesit që kërkohen për të trajtuar rrezikun e anomalisë materiale. Përveç kësaj, metoda e auditimit në një periudhë të caktuar mund të ketë qenë ndikuar nga rrethanat specifike të entitetit, kushtet ekonomike, apo zhvillimet e sektorit të ekonomisë. Ajo mund të jetë gjithashtu, e dobishme për audituesin, për t'ju referuar natyrës dhe shtrirjes së komunikimeve me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje me këtë çështje.

A49. Për shembull, për të përshkruar metodën e audituesit për çmuarjen kontabël që ka qenë identifikuar se ka patur një pasiguri të lartë tëçmuarjes, siç është vlerësimi i instrumenteve financiare komplekse, audituesi mund të dëshirojë të theksojë se ai ka angazhuar ose punësuar një ekspert të audituesit. Një referencë e tillë mbi përdorimin e ekspertit të audituesit, nuk e zvogëlon përgjegjësinë e audituesit për opinionin mbi pasqyrat financiare dhe për këtë arsye, nuk është në kontradiktë me paragrafët 14-15 të SNA 620.³²

³²SNA 620, Përdorimi i Punës së Ekspertit të Audituesit

- A50. Mund të ketë sfida në përshkrimin e procedurave të audituesit, sidomos në fushat e ndërlikuara të gjykimit të auditimit. Veçanërisht, e vështirë mund të jetë paraqitja e procedurave të kryera në mënyrë të përmbledhur, që të lejojë komunikimin e përshtatshëm të natyrës dhe shtrirjes së përgjigjes së audituesit ndaj rrezikut të vlerësuar të anomalisë materiale, dhe përfshirjen e gjykimevetë rëndësishme të audituesit. Megjithatë, audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të bëjëpërshkrimin e procedurave të caktuara të kryera, për të komunikuar mënyrën se si çështja është trajtuar në auditim. Një përshkrim i tillë, zakonisht mund të jetë në nivele të larta, në vend që të përfshijë një përshkrim të detajuar të procedurave.
- A51. Siç është përmendur në paragrafin A46, në përshkrimin e çështjes kryesore të auditimit në raportin e audituesit, audituesi mund të japë edhe një tregues të rezultateve të përgjigjes së tij. Megjithatë, kur kjo është bërë, duhet të tregohet kujdes për të shmangur përshtypjen se me përshkrimin e bërë, audituesi ka dhënë një opinion të veçantë për një çështje individuale kryesore të auditimit, apo që në ndonjë mënyrë, mund të vërë në dyshim opinionin e audituesit për pasqyrat financiare në tërësi.

Rrethanat në të Cilat një Çështje e Përcaktuar si Çështje Kryesore e Auditimit Nuk Komunikohet në Raportin e Audituesit (Ref: Para. 14)

- A52. Ligji ose rregullat mund të ndalojnë bërjen publike nga drejtimi ose nga audituesi të një çështjeje specifike të përcaktuar si çështje kryesore e auditimit. Për shembull, ligji ose rregullat mund të ndalojnë në mënyrë të veçantë çdo komunikim publik që mund të cënonte një hetim nga një autoritet kompetent të një veprimi të paligjshëm, faktik ose të dyshuar, (për shembull, çështjet që janë ose mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave).
- A53. Siç tregohet në paragrafin 14(b), ndodh shumë rrallë që një çështje e përcaktuar si çështje kryesore e auditimit të mos komunikohet në raportin e audituesit. Kjo pasi presupozohet se paraqitja e një transparence më të madhe në lidhje me auditimin për përdoruesit e synuar, ka një përfitim në interes të publikut. Për këtë arsye, vendimi për të mos komunikuar një çështje kryesore auditimi është i përshtatshëm vetëm në rastet kur pasojat negative ndaj entitetit ose publikut si rezultat i një komunikimi të tillë, shihen kaq të rëndësishme sa që në mënyrë të arsyeshme ato pritet t'i tejkalojnë përfitimet me interes publik që vijnë nga komunikimi i kësaj çështjeje.
- A54. Vendimi për të mos komunikuar një çështje kryesore të auditimit merr në konsideratë faktet dhe rrethanat lidhur me këtë çështje. Komunikimi me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, e ndihmon audituesin të kuptojë pikëpamjet e drejtimit në lidhje me rëndësinë e pasojave negative që mund të lindin si rezultat i komunikimit të kësaj çështjeje. Në veçanti, komunikimi me drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen ndihmon në gjykimin e audituesit për përcaktimin nëse duhet të komunikojë çështjen, duke:

- Ndhimuar audituesin të kuptojë se pse kjo çështje nuk është bërë publike nga entiteti (p.sh., në qoftë se ligji, rregullat apo kuadri i caktuar i raportimit financiar lejon bërjen e mëvonshme ose mosbërjen publike të çështjes) dhe pikëpamjet e drejtimit për pasojat negative, nëse ka, të bërjes publike. Drejtimi mund të tërheqë vëmendjen për aspekte të caktuara në ligj ose rregulla apo burime të tjera autoritare që mund të kenë lidhje me shqyrtimin e pasojave negative (për shembull, aspekte të tilla mund të përfshijnë dëmin ndaj negociatave tregtare ose pozicionit konkurrues të entitetit). Megjithatë, pikëpamjet e drejtimit vetëm në lidhje me pasojat negative nuk zvogëlojnë nevojën e audituesit për të përcaktuar nëse pasojat negative të arsyeshme pritet të jenë më të mëdha se përfitimet me interes publik që vijnë nga komunikimi në përputhje me paragrafin 14(b).
- Theksuar nëse ka pasur ndonjë komunikim me autoritetet rregullatore, detyruese ose mbikëqyrëse në lidhje me këtë çështje, në veçanti nëse këto diskutime duken të jenë në mbështetje të pohimit të drejtimit se pse bërja publike e kësaj çështje nuk është e përshtatshme.
- I dhënë mundësi audituesit, kur është rasti, që të inkurajojë drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen për të bërë publike informacionet që kanë lidhje me këtë çështje. Në veçanti, kjo mund të jetë e mundur në qoftë se shqetësimet e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me komunikimin janë të kufizuara në aspekte të veçanta që kanë të bëjnë me këtë çështje, në mënyrë që ky informacion në lidhje me këtë çështje të jetë më pak sensitiv dhe të mund të komunikohet.

Audituesi gjithashtu, mund të konsiderojë të nevojshme marrjen e një deklarate me shkrim nga drejtimi për arsytet pse bërja publike për këtë çështje nuk është e përshtatshme, duke përfshirë në të edhe pikëpamjen e drejtimit në lidhje me rëndësinë e pasojave negative që mund të lindin si rezultat i një komunikimi të tillë.

- A55. Mund të jetë e nevojshme gjithashtu, që audituesi të marrë në konsideratë pasojat e komunikimit në lidhje me një çështje të përcaktuar si çështje kryesore e auditimit, në dritën e kërkesave përkatëse etike. Përveç kësaj, audituesit mund t'i kërkohet nga ligji ose rregullat që të komunikojë me autoritetet rregullatore, detyruese ose mbikëqyrëse në lidhje me këtë çështje, pa marrë parasysh nëse çështja është komunikuar në raportin e audituesit. Një komunikim i tillë mund të jetë i dobishëm për të informuar gjykimin e audituesit për pasojat negative që mund të lindin nga komunikimi në lidhje me këtë çështje.
- A56. Aspektet që konsiderohen nga audituesi të lidhura me vendimin për të mos komunikuar një çështje janë komplekse dhe përfshijnë një gjykim të rëndësishëm të audituesit. Për këtë arsye, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme marrjen e këshillave ligjore.

Forma dhe Përmbajtja e Seksionit të Çështjeve Kryesore të Auditimit në Rrethana të Tjera (Ref: Para. 16)

A57. Kërkesa në paragrafin 16 zbatohet në tre rrethana:

- Audituesi përcakton në përputhje me paragrafin 10, se nuk ka çështje kryesore të auditimit (shiko paragrafin A59).
- Audituesi përcakton në përputhje me paragrafin 14, se një çështje kryesore e auditimit nuk do të komunikohet në raportin e audituesit dhe se nuk ka çështje të tjera të përcaktuara si çështje kryesore të auditimit.
- Të vetmet çështje të përcaktuara si çështje kryesore të auditimit janë ato të komunikuar në përputhje me paragrafin 15.

A58. Në vijim ilustron paraqitja në raportin e audituesit në rastin kur ky i fundit ka përcaktuar se nuk ka çështje kryesore auditimi për të komunikuar:

Çështjet Kryesore të Auditimit

[Me përjashtim të çështjes së trajtuar në Seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë (Kundër) apo në seksionin e Pasigurisë Materiale në Lidhje me Vijimësinë,] Ne kemi përcaktuar se nuk ka [të tjera] çështje kryesore të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

A59. Përcaktimi i çështjeve kryesore të auditimit përfshin gjykimin në lidhje me rëndësinë përkatëse të çështjeve që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit. Prandaj, ndodh rrallë që audituesi i një pakete të plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të një entiteti të listuar, të mos përcaktojë ndërmjet çështjeve të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, të paktën një çështje kryesore auditimi për t'u komunikuar në raportin e audituesit. Megjithatë, në disa rrethana të kufizuara (për shembull, për një entitet të listuar që kryen veprime shumë të kufizuara), audituesi mund të përcaktojë se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit në përputhje me paragrafin 10, pasi nuk ka çështje që të kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit.

Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen (Ref: Para. 17)

A60. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen në mënyrë periodike.³³ Kohëzgjatja e përshtatshme për komunikim në lidhje me çështjet kryesore të auditimit ndryshon sipas rrethanave të angazhimit. Megjithatë, audituesi mund të komunikojë pikëpamjet paraprake në lidhje me çështjet kryesore të auditimit kur diskutohet për objektin e planifikuar dhe afatet e auditimit, dhe mund të diskutohet më tej mbi këto çështje, kur komunikohet në lidhje

³³SNA 260 (i rishikuar), paragrafi 21

me gjetjet e auditimit. Kjo mënyrë të vepruari mund të ndihmojë për të lehtësuar sfidat praktike, në përpjekje për të patur një dialog të dyanshëm të fortë për çështjet kryesore të auditimit në kohën kur pasqyrat financiare janë duke u finalizuar për t'u dorëzuar.

- A61. Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen i mundëson ata të bëhen të vetëdijshëm për çështjet kryesore të auditimit që audituesi ka për qëllim të komunikojë në raportin e audituesit, dhe u jep atyre mundësi të marrin sqarime të mëtejshme kur është e nevojshme. Për të lehtësuar diskutimin, audituesi mund të konsiderojë të dobishme vënien në dispozicion të personave të ngarkuar me qeverisjen të një draft raporti të audituesit. Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen njihet rolin e tyre të rëndësishëm në mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar dhe bën të mundur që këta persona të kuptojnë bazën për vendimet e audituesit në lidhje me çështjet kryesore të auditimit dhe për mënyrën se si këto çështje do të përshkruhen në raportin e audituesit. Ai gjithashtu, ju mundëson personave të ngarkuar me qeverisjen të marrin në konsideratë nëse dhënia e informacioneve shpjeguese të reja ose të përmirësuara mund të jetë e dobishme në dritën e faktit se këto çështje do të komunikohen në raportin e audituesit.
- A62. Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen që kërkohet nga paragrafi 17(a) trajton edhe rrethanat jashtëzakonisht të rralla në të cilat një çështje e përcaktuar si çështje kryesore auditimi nuk është komunikuar në raportin e audituesit (shiko paragrafët 14 dhe A54).
- A63. Kërkesa në paragrafin 17(b) për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen në rastin kur audituesi ka përcaktuar se nuk ka çështje kryesore të auditimit për të komunikuar në raportin e audituesit, i jep një mundësi audituesit të ketë diskutime të mëtejshme me të tjerë individë, të cilët janë të familjarizuar me auditimin dhe me çështjet e rëndësishme që mund të kenë lindur (përfshirë rishikuesin e kontrollit të cilësisë së angazhimit, nëse është caktuar një i tillë). Këto diskutime mund të sjellin si rezultat rivlerësimin e audituesit se nuk ka çështje kryesore të auditimit.

Dokumentimi (Ref: Para. 18)

- A64. Paragrafi 8 i SNA 230 kërkon që audituesi të përgatisë dokumentacionin e auditimit, i cili është i mjaftueshëm për të bërë të mundur që një auditues me përvojë, pa lidhje të mëparshme me auditimin, të kuptojë, ndër të tjera, gjykimet e rëndësishme profesionale. Në kontekstin e çështjeve kryesore të auditimit, këto gjykime profesionale përfshijnë përcaktimin, midis çështjevetë komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, të atyre çështjeve që kërkojnë vëmendje të konsiderueshme të audituesit, si dhe faktin nëse secila prej këtyre çështjeve është ose jo një çështje kryesore e auditimit. Gjykimet e audituesit në këtë drejtim ka të ngjarë që të mbështeten nga dokumentimi i komunikimit të audituesit me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe nga dokumentacioni i auditimit për çdo çështje të veçantë (shiko paragrafin A39), si edhe nga dokumentacioni tjetër i caktuar i

auditimit për çështje të rëndësishme që dalin gjatë auditimit (p.sh., një memorandum përmbyllës). Megjithatë, kjo SNA nuk kërkon nga audituesi që ai të dokumentojë se pse çështjete tjera të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen nuk ishin çështje për të cilat kërkohej vëmendje e konsiderueshme e audituesit.